



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

RAPORTIMI DHE FINANCIMI









**RAPORTIMI I VIZITAVE TE KRYERA
DHE
PASQYRA FINANCIARE**

**RAPORTIMI I VIZITAVE TE MINISTRIT TE SHETIT PER DIASPOREN
DHE
PASQYRA FINANCIARE E UDHETIMEVE (2017-2018)**

Itali, 12-14 Dhjetor 2017

AQUILA, ITALI

-Takim me Presidentin e Provincës Angelo Caruso si dhe Zëvendëskryetarin e Bashkisë Guido Iliris. Në fokus të bisedave ishte modeli i integritit të komunitetit shqiptar të Aquila-s dhe marrëdhëniet e tij me shtetin amë.

-I shoqëruar nga Ambasadorja e Shqipërisë në Itali, Znj. Anila Bitri delegacioni i Ministrisë mori pjesë në aktivitetin që u zhvillua në Romë "Takohemi për një libër". Në takimet me Shoqatat Shqiptare, Ministri u informua mbi aktivitetet e tyre si dhe diskutoi për rolin e Ministrisë të Shtetit për Diasporën në riorganizimin e Shoqatave Shqiptare, të cilat veprojnë jashtë atdheut.

Ukrainë, 13-16 Janar 2018

KARAKURT

-Delegacioni e nisi vizitën në fshatin e banuar kryesisht nga shqiptare, Karakurt, në rajonin e Odesës ku u prit nga autoritetet rajonale e gjithashtu përfaqësuesit e diasporës shqiptare. Në këtë vizitë Ministri Majko u shoqërua nga Ambasadorja e Shqipërisë Shpresa Kureta dhe konsulli i nderit z. Omarov. U zhvilluan takime edhe me krerët e qytetit të Bollgradit dhe të fshatit Karakurt, të tillë si; znj. Zhecheva Elena Dmitrievna, kryetare e fshatit Karakurt; z. Musienko Denis Volodymyrovych, kryetar i Administratës Shtetërore Regjionale të Bolgradës; z. Dimitrov Dmitry Stepanovich, kryetar i Këshillit të Qarkut Bolgrad. Mësimi i gjuhës shqipe dhe furnizimi me libra ishin kërkesat kryesore të këtij komuniteti.

-Delegacioni vizitoi shkollën shqipe në Karakurt, ndoqi një orë mësimi dhe mori pjesë në shfaqje të organizuara nga komuniteti shqiptar.

KIEV

-Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko u takua me zv.Kryeministren e Ukrainës znj. Ivanna Klympush-Tsintsadze, zv.Ministrin e Punëve të Jashtme, z. Bodnar Vasily Mironovich; zv. Ministrin e Parë të Arsimit dhe Shkencës, z. Kovtunets Vladimir Vitalievich; zv.Ministren e Kulturës, znj. Fomenko Svetlana Valeriivna. Bisedimet prodhuan rezultate të rëndësishme si: implementimi i projekteve të përbashkëta në arsim dhe kulturë, Krijimi i Katedrës Shqipe në Ukrainë dhe dakordësimi lidhur me bursat për studentët shqiptarë në nivelet Bachelor, Master dhe Phd.

Maqedoni, 24 Janar 2018

OHËR

Takim trepalësh i Ministrave të Diasporës së Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës

-Gjatë takimit trepalësh në Ohër, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, Ministri i Diasporës së Maqedonisë, z. Edmond Ademi dhe Ministri i Diasporës së Kosovës, z. Dardan Gashi vlerësuan se bashkëpunimi në fushën e diasporës është i dobishëm dhe një fushë e rëndësishme për thellimin e bashkëpunimit midis tre shteteve në rajon. Takimi i Ohrit u konsiderua si një fillim i rëndësishëm për të nxitur veprim të përbashkët në forcimin e lidhjeve midis vendeve në kuadër të procesit të integritit euroatlantik. Ministrat ranë dakord të kryejnë vizita të përbashkëta në SHBA, Gjermani dhe vende të tjera për të takuar komunitetet e diasporës. Takimi u përmyll me firmosjen e deklaratës së takimit të Ohrit.

Greqi, 25-27 Janar 2018

ATHINË

-Ministri Majko, u takua me zyrtarë të lartë grekë e përfaqësues të komunitetit shqiptar në Athinë.

-Në takimin me Ministrin e Brendshëm z. Panagiotis Skourletis u diskutua për mbrojtjen e komunitetit shqiptar dhe ripërtëritja e marrëdhënieve mes dy vendeve.

-Në takimin me Kryetaren e Grupit të Miqësisë Shqipëri - Greqi, znj. Meropi Tzoufi, palët u dakordësuan mbi nevojën e koordinimit për aktivitete e projekteve të përbashkëta.

-Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi një takim me Zëvendës Guvernatorin e rajonit të Atikës, z. Petros Filippou ku u prekën çështje të interesit dypalësh, me në fokus komunitetin shqiptar që jeton në Greqi. Z. Filippou u tregua i gatshëm të ndihmojë për nxitjen e bashkëpunimit me autoritetet rajonale.

-Ministri u takua me përfaqësues të medias, gazetarë e korrespondentët si dhe intelektualë që jetojnë dhe punojnë në Athinë, me mësues të gjuhës shqipe, përfaqësues të shoqatave shqiptare etj. Problematikat e komunitetit shqiptar në Greqi ishin në fokus të bisedimeve mes Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe Avokatit të Popullit në Greqi z. Andreas I. Pottakis.

SELANIK

-Gjatë qëndrimit të tij në Selanik, Ministri i Shtetit për Diasporën, u takua me përfaqësues të shoqatave shqiptare atje. Z. Pandeli Majko i informoi ata lidhur me hapat që po ndërmerren në mbështetje të diasporës shqiptare, Z. Majko e vuri theksin tek rëndësia e përfshirjes në votime të shtetasve shqiptarë jashtë vendit

ROME

-Ministrit i Shtetit për Diasporën, në shoqërimin e Ambasadores shqiptare në Romë, znj. Anila Bitri, ndoqën meshën e mbajtur në gjuhën shqipe, në kishën e hershme “San Giovanni della Malva in Transtevere”.

-Z. Majko u takua me Drejtoreshën e Përgjithshme të Migracionit dhe Politikave të Integritimit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale në Itali, znj. Tatiana Esposito duke kërkuar një bashkëpunim të ngushtë me strukturat italiane për zgjidhjen e problematikave për komunitetin tonë atje.

-Ministri mori pjese në konferencën “Itinerar shqiptar”, e cila kishte në fokus eksperiencat e emigrantëve shqiptarë në Itali. Në konferencë z. Majko e vuri theksin tek shembulli pozitiv që përfaqëson komuniteti shqiptar në Itali.

-Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko u prit nga një delegacion i Ministrisë së Jashtme Italiane, i kryesuar nga z. Luigi Vignali. Z. Majko informoi zyrtarët e Ministrisë së Jashtme Italiane mbi ndryshimet normative që po bëhen në lidhje me diasporën dhe theksoi nevojën e shkëmbimit të eksperiencave mes administratave të të dyja vendeve. Gjatë diskutimeve u prekën çështje të rëndësishme të rëndësishme që shqetësojnë shqiptarët e Italisë, si ajo e votës, pensione dhe sigurimeve shëndetësore. Bashkëpunimi për projekte të përbashkëta mes shtetit shqiptar dhe atij italian ishte një tjetër temë e rëndësishme e prekur në bisedime.

-Në takimin e zhvilluar në Ministrinë Italiane të Kulturës me znj. Dorina Bianchi, Ministri i Shtetit për Diasporën, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e kulturës e gjithashtu pasurive kulturore. Gjatë bisedimeve u fol mbi intensifikimin e përpjekjeve për përfshirjen më të madhe të komunitetit shqiptar në aktivitetet kulturore dhe shkëmbimin e eksperiencave mes dy vendeve. Ministri kërkoi një bashkëpunim më të ngushtë me Ministrinë e Kulturës sa i përket kandidaturës së arbëreshëve për tu renditur mes pasurive kulturore të UNESCO-s. Në këtë aspekt, palët u dakordësuan mbi nevojën e një nismë ndërqeveritare.

MICHIGAN

-Z. Majko, i shoqëruar nga Ambasadorja e Shqipërisë në SHBA, znj. Floreta Faber, Konsulli i Nderit, z. Ekrem Bardha dhe përfaqësues të tjerë të diasporës atje, vizitoi qendrat fetare të komunitetit shqiptar në Rochester Hills, Miçigan të cilat shërbejnë edhe si qendra kulturore për shtetasit shqiptarë. Ministri u takua me përfaqësues të shoqatave të ndryshme shqiptaro-amerikane.

NEW YORK

-Takim me sipërmarrësin e suksesshëm shqiptar, Richard Lukaj në Qendrën Rinore Shqiptare “Stamford”, e themeluar prej tij. Z. Majko u takua me përfaqësuesit e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, të cilët i vlerësoi për kontributin në promovimin dhe ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar në Shtetet e Bashkuara. Ai sugjeroi organizimin e një aktiviteti të përvitshëm, i cili në qendër do të ketë librin shqip. Z. Richard Lukaj shprehu vullnetin për të ndihmuar me krijimin e një biblioteke për komunitetin shqiptar, që do të jetë një nga më të mëdhatë e këtij lloji.

-I shoqëruar nga Ministri për Diasporën në Kosovë, z. Dardan Gashi, Ministri Majko zhvilloi një takim me drejtorët dhe mësuesit e shkollave shqipe, duke u njohur me kushtet dhe problematikat kryesore me të cilat përballen. Një prej shqetësimeve kryesore të tyre ishte sigurimi i librave të gjuhës shqipe dhe të dy Ministrat u shprehën të gatshëm për të ndihmuar.

-Takim me përfaqësuesit e shoqatës APEN, e cila ka si qëllim bashkimin dhe promovimin e shqiptarëve profesionistë. Ministri theksoi rëndësinë e organizimit të aktiviteteve vjetore ku të trajtohen tema të rëndësishme që prekin komunitetin shqiptar në SHBA.

WORCESTER, MASSACHUSETTS

-Ministri Majko nderohet me Çelësin e Qytetit. Në shenjë mirënjohje për kontributin e komunitetit shqiptar në qytetin e Worcester në Massachusetts, Kryebashkiaku i këtij qyteti z. Joseph Petty, e nderoi Ministrin e Shtetit për Diasporën me Çelësin e Qytetit. Z. Pandeli Majko vizitoi qytetin ku jeton një numër i konsiderueshëm shqiptarësh, i shoqëruar nga Ambasadorja e Shqipërisë në SHBA, znj. Floreta Faber.

-Vizitë në qendrën ‘Ilirian Garden’, e konceptuar si një shtëpi për brezin e tretë pikërisht nga emigrantë shqiptarë.

DETROIT, MICHIGAN

-Takime me përfaqësues të komunitetit shqiptar në 'Troy Community Center' dhe me studentë shqiptarë, me të cilët Ministri bisedoi lidhur me iniciativat që do të përfshijnë këtë pjesë të komunitetit.

-Takim me Senatorin e Shtetit Të Miçiganit, njëkohësisht Kryetar i Grupit për Çështjet Shqiptare në Senat, z. Gary Peters. Z. Majko u ndal tek rëndësia që qeveria i kushton komunitetit shqiptar në SHBA, si një prej komuniteteve më të mëdha.

-Ministri i Shtetit për Diasporën dhe homologu i tij në Kosovë z. Dardan Gashi, u takuan me familjarë e ish ushtarë të Batalionit 'Atlantiku', të cilët gjatë luftës së viteve '90-të në Kosovë, lanë familjet, shtëpitë dhe punën që kishin në SHBA, për tu bërë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dy Ministrat vizituan familjen Bytyçi, tre pjesëtarë të së cilës u vranë nga forcat serbe në vitin 1999-të.

-Ministri i Shtetit për Diasporën dha një intervistë për televizionin 'Albanian Tv of America' ku foli për çështjet e diskutuara me komunitetin shqiptar atje, për strategjinë për diasporën dhe tema të tjera që prekin shtetasit tanë jashtë vendit.

BOSTON (UNIVERSITETI I HARVARDIT)

-Ministri u takua me studentë shqiptarë dhe profesorë në universitetin prestigjioz. Në fjalën e mbajtur atje, z. Majko e vuri theksin tek shfrytëzimin e potencialit të shqiptarëve të suksesshëm. Në vijim Ministri i Shtetit prezantoi për panelin në Harvardit edhe një video që shpaloste resurset natyrore e njerëzore të Shqipërisë.

WASHINGTON

-Takim me përfaqësuesit e "Open Gov Hub", një rrjet prej 40 organizatash joqeveritare që vepron në mbi 100 vende, përfshirë edhe Shqipërinë, për të promovuar transparencën, përgjegjësinë dhe angazhimin civil rreth botës.

- Ministri Majko i shoqëruar nga Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj dhe Ministri për Diasporën në Kosovë, z. Dardan Gashi morën pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Washington.

-Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Washington, me rastin e përvjetorit të pavarësisë. Mes të ftuarëve në aktivitet ishte Këshilltari për Sigurinë Kombëtare, z. Herbert Raymond McMaster, me të cilin Ministri Majko zhvilloi një takim.

-Ministri i Shtetit për Diasporën, në një intervistë për Zërin e Amerikës në Washington, foli më gjerësisht për hapat që janë ndërmarrë në 120 ditë për forcimin e lidhjes së shtetit me diasporën.

-Takim në Departamentin Amerikan të Shtetit me zv. Drejtoren e Zyrës për Çështjet e Evropës Qëndrore e Jugore, znj. Susan K. Falatko. Në fokus të bisedimeve ishte reforma në fushën e diasporës, me Ministrin që informoi zyrtaren e lartë për arritjet dhe përpjekjet që po bëhen në këtë aspekt, në bashkëpunim me qeverinë.

Qëllimi i takimit në Washington është forcimi i lidhjeve mes Shqipërisë dhe institucioneve

RINI VERIOR-VESTFALI

Pas kërkesave të shumta të komunitetit shqiptar në Dusseldorf, Ministri Majko zhvilloi një vizitë pune në Gjermani. Axhenda e tij u bashkërendua nga z. Artur Kuko, ambasadori shqiptar në Gjermani dhe znj. Anduena Stephan, konsulle nderi.

-Takim me sipërmarrësin e suksesshëm, z. Lazim Destani. Me ftesë të z. Lazim Destani, Ministri Majko vizitoi zyrat e tij në qendër të Dusseldorf-it. Gjatë takimit miqësor u diskutua për potencialet turistike të Shqipërisë, me theks të veçantë tek iniciativat që do të ndihmojnë për tërheqjen e investimeve të huaja. Një nga tematikat e takimit ishte krijimi i dhomës së biznesit të diasporës.

-Në takimet me përfaqësues të shoqatës së mjekëve shqiptarë, arsimtarë dhe deputetë në gjermani z. Majko e vuri theksin te nxitja e krijimit të një rrjeti profesionistësh, jo vetëm në Gjermani por edhe në Itali dhe Greqi.

-Ne takimet me përfaqësues të Bashkësisë shqiptare në Gjermani u diskutua për arsimin shqip në Gjermani, vendosjen e standardeve të përbashkëta arsimore me Kosovën dhe problematika të komunitetit shqiptar atje. U diskutua për kurrikulën dhe rolin e teknologjisë në mësimin e gjuhës shqipe. Ministri i Shtetit për Diasporën prezantoi iniciativat që po ndërmerren në këtë aspekt, si ato të librave online dhe krijimit të një rrjeti të profesionistëve në internet.

-Takim me deputetin e landit të Rinit Verior-Vestfali nga rradhët e SPD-së, Sebastian Watermeier, njëkohësisht Anëtar i Komisionit Parlamentar për Europën dhe Kulturën e gjithashtu me përfaqësues shqiptarë të politikës gjermane, në qytetin e Gelsenkirchen. U diskutua për multikulturalizmin që karakterizon landin dhe të gjithë Gjermaninë.

-Ministri u takua me Moderatorët e Tryezave të Rrumbullakëta Ditë Dialogu, nën organizimin e shoqatës Gjermano-Shqiptare "Ideal".

-Vizitë në shkollën shqipe në Bocholt, ku tradita e mësimin të gjuhës shqipe përcillet prej më shumë se 30 vjetësh. Gjatë takimit u fol për mundësinë e binjakëzimit të shkollave, shkëmbimin e adresave dhe krijimin e një rrjeti virtual.

-Në qytetin e Bocholt, Ministri u takua edhe me pjesëtarë të tjerë të komunitetit shqiptar, mes të cilëve mjekë, inxhinierë, deputetë, juristë etj. Rritja e bashkëpunimit me autoritetet lokale për çështje që prekin shtetasit shqiptarë në Gjermani ishin në qendër të bisedimeve që zhvilloi Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko me z. Mark Speich, Sekretar i Shtetit për Çështjet Federale dhe Evropiane, Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Mediave në landin e Rinit Verior-Vestfali.

ONTARIO

-Takimi i parë institucional u zhvillua me kreun e Asamblesë Legjislative të Ontarios, z. Dave Levac, i cili vuri theksin tek rëndësia e ruajtjes së lidhjeve me vendin e origjinës, diçka që sipas tij ndikon në krijimin e një modeli të suksesshëm integrimi. Ministri Majko përshëndeti përpjekjet e autoriteteve lokale në këtë aspekt duke vlerësuar përfshirjen e gjuhës shqipe në programin shkollor.

-Ne takimin e zhvilluar me përfaqësuesit e 'bashkësisë shqiptaro-kanadeze', Ministri Majko dhe homologu nga Kosova z. Dardan Gashi u njohën me punën dhe potencialin e shoqatës. Përfaqësuesit e shoqatës informuan z. Majko lidhur me projektin e ngritjes së "Shtëpisë së Shqiptarit", siç do të quhet qendra që do të dedikohet aktiviteteve kulturore shqiptare. Struktura do të shërbejë si pikë takimi e diasporës dhe në sallat e saj do të zhvillohen edhe kurse të gjuhës shqipe.

-Ambasadat e Shqipërisë dhe Kosovës organizuan një pritje në nder të dy Ministrave të Diasporës, z. Pandeli Majko e z. Dardan Gashi dhe gjithashtu përfaqësuesëve të komunitetit shqiptar në Ontario. Të ftuar në pritjen e zhvilluar në ambjentet e parlamentit të Ontarios ishin znj. Laura Albanese, Ministre për Emigracionin, Kreu i Asamblesë Legjislative z. Dave Levac, z. Reza Moridi, Ministër i Shkencës dhe Inovacionit në qeverinë lokale, z. Shafiq Qadri, deputet dhe mik i komunitetit shqiptar etj. Të ftuarit vizituan më pas ekspozitën fotografike të mundësuar nga Ambasada e Shqipërisë. E çelur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ekspozita kishte në qendër gruan shqiptare përgjatë dekadave.

-Në takimin me ministren e emigracionit, znj. Laura Albanese z. Majko e falënderoi atë për mbështetjen e fortë që i ka dhënë ligjit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare. Dy zyrtarët diskutuan mbi mundësinë e një dialogu me autoritetet federale sa i përket çështjes së mësimdhënies për diasporën shqiptare.

-Tërheqja e investimeve kanadeze në Shqipëri ishte në fokus të bisedimeve të zhvilluara mes Ministrit Pandeli Majko dhe drejtorit ekzekutiv të Këshillit të Bizneseve Kanadezo-Shqiptare Robert Baines, njëkohësisht president i NACO (Nato Association of Canada).

-Në Hamilton, z. Majko vizitoi ambjentet e disa bizneseve të suksesshme shqiptare.

TORONTO

-Ministri i shtetit për diasporën u takua me përfaqësues të 'Albanian Canadian Excellence Society', shoqata ku bëjnë pjesë profesionistë të rinj, të suksesshëm, plotësisht të integruar në shoqërinë kanadeze. Ministri Majko dhe homologu i tij në Kosovë u shprehën të gatshëm.

-Takime me përfaqësues të tjerë të komunitetit shqiptar në Toronto.

OTTAWA

-Vizitë në shkollën shqipe të Ottawa, ku që nga viti 2000, gjuha shqipe është përfshirë në programin mësimor si gjuhë e tretë, pas anglishtes dhe frëngjishtes. Ministri kërkoi që fëmijëve t'u flitej në gjuhën amtare, për ta përcjellë identitetin shqiptar nëpër breza.

-Ministri Majko mori pjesë në pritjen e organizuar në bashkinë e Ottawa-s nga Ambasada e Shqipërisë. Të pranishëm ishin Ambasadori shqiptar z. Ermal Muça dhe përfaqësues të komunitetit shqiptar nga Ottawa dhe Montreali. Në ambientet e Bashkisë u shfaq edhe një ekspozitë dedikuar gruas shqiptare. Në fjalën e tij përshëndetëse, Zv.Kryetari i Bashkisë z. Bob Monette vlerësoi kontributin e diasporës shqiptare në këtë qytet dhe u shpreh i nderuar për vizitën e Ministrit.

-Takim me Ministrin për Refugjatët, Migracionin dhe Shtetësinë në Kanada, z. Ahmed Hussen. Dy zyrtarët diskutuan lidhur me marrëveshjen për pensionet, një çështje me shumë interes për shqiptarët në Kanada. Gjatë bisedës u tha se draft marrëveshja është finalizuar dhe të dyja palët janë gati ta firmosin. Lehtësimi i lëvizjes së qytetarëve ishte një tjetër temë e rëndësishme e prekur në takim. Z. Hussen informoi z. Majko se Kanadaja po ndërmerret një reformë për të mundësuar lehtësimin e lëvizjes, veçanërisht për studiuesit, studentët dhe sipërmarrësit që kanë lidhje biznesi në Kanada.

LONDER

Në vijim të ftesave të shumta nga komuniteti shqiptar në Britaninë e Madhe, Ministri Majko në bashkërendim me ambasadorin e Shqipërisë, z. Qirjako Qirko dhe atë të Kosovës, z. Lirim Greiçevsi realizoi një vizitë zyrtare në Londër.

-Takimet nisën me komunitetin shqiptar në Londër. Z. Majko tha se ishin ndërmarrë hapa të rëndësishëm për krijimin e strukturave që do të mundësojnë forcimin e marrëdhënies së shqiptarëve jashtë vendit me shtetin e tyre.

-Ministri i Shtetit për Diasporën vizitoi ambientet e «4 M Group», një studio e suksesshme arkitekture në Londër, e themeluar nga shqiptarë. Drejtor ekzekutiv i firmës është z. Përparim Rama, ndërsa shqiptarë të tjerë përbëjnë grupin e arkitektëve, disenjatorëve e ndërtuesëve të talentuar.

-Ministri i Shtetit për Diasporën në ambientet e Organit më të Lartë Legjislativ të Mbretërisë së Bashkuar. Ministri Pandeli Majko u takua me deputetë britanikë, ndër të cilët laburisti, z. John Grogan, njëkohësisht kryetar i grupit gjithë partiak të miqësisë Shqipëri-Britani, z. Andreë Francis Slaughter, z. Martin Vickers, z. John Whittingdale, znj. Seema Malhotra, baronesha Anelay of St Johns etj. Ministri falënderoi politikanët për rolin e tyre në krijimin e mundësive për diasporën tonë atje. Duke u ndalur tek arsimit, z. Majko vlerësoi mbështetjen që u është dhënë iniciativave për ngritjen e shkollave shqipe, por kërkoi që të mundësohet përfshirja e mësuesëve shqiptarë në sistemin shtetëror të arsimit. Gjatë takimit, deputetët i drejtuan pyetje Ministrin lidhur me strategjinë e shtetit shqiptar për diasporën dhe synimin për t'u garantuar emigrantëve të drejtën e votës.

-Ministri i Shtetit për Diasporën u bë zyrtari i parë i lartë shqiptar që vizitoi shkollën plotësuese shqipe në Kilburn të Londrës. Shkolla, e themeluar me iniciativë të organizatava shqiptare që veprojnë atje, ofron kurse të gjuhës shqipe gjatë së shtunës. Z.Majko e vuri theksin tek rëndësia e të folurit shqip në familje dhe informoi mësuesit, prindërit dhe përfaqësuesit e shoqatës “Ardhmëria” mbi planin e përbashkët të veprimit me qeverinë e Kosovës, sa i përket arsimit shqip në diasporë.

-Ministri i Shtetit për Diasporën vizitoi organizatën ‘Total Family Coaching’, e drejtuar nga një shqiptare nga Prishtina, znj. Adelina Badivuku.

-Vizitë në bustin e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

-Ministri i Shtetit për Diasporën e mbylli vizitën e tij në Londër në pritjen e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar

Itali, 25-28 Mars 2018

MODENA

-Në takimim me komunitetin shqiptar Ministri foli për rëndësinë e konsolidimit të lidhjeve mes shqiptarëve atje dhe shtetit. Ndërsa vlerësoi përpjekjet dhe iniciativat e komunitetit në Itali, z. Majko pohoi se nevojitet një organizim më i madh në nivel rajonal dhe shtetëror.

PARMA

-Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko dhe Ministria e Arsimit znj. Lindita Nikolla zhvilluan një takim me përfaqësues të komunitetit shqiptar dhe qeverisë lokale të Parmës në kuadër të procesit informues për projektin “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”. Në takim morën pjesë përfaqësues të IOM në Shqipëri, agjencia e OKB-së që zbaton projektin, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe përfaqësues të Kooperacionit Italian që mbështet financiarisht këtë program. Përfaqësuesit e shoqatës “Skanderbeg”, organizues të aktivitetit, njohën zyrtarët shqiptarë me iniciativat dhe angazhimin e tyre për forcimin e marrëdhënieve mes bashkisë së Parmës dhe asaj të Tiranës.

-Në takimim e zhvilluar me përfaqësuesit e shkollës shqipe “Skanderbeg Parma”, Ministrat Pandeli Majko e Lindita Nikolla u ndalën tek përpjekjet që po bëhen për të mundësuar përfshirjen e mësuesëve shqiptarë në sistemin shtetëror. U përmendën përpjekjet që po bëhen për të mundësuar një qasje më të lehtë ndaj librave shqip, përmes teknologjisë.

-Krijimi i një rrjeti biznesesh shqiptare në Itali dhe rritja e bashkëpunimit me sipërmarrësit atje, ishin në fokus të takimit të zhvilluar në Parma, mes Ministrit Pandeli Majko dhe përfaqësuesëve të CNA, Konfederata Kombëtare e Artizanatit dhe Sipërmarrjes së Vogël e të Mesme.

-Ministrat Pandeli Majko dhe Lindita Nikolla u pritën në Bashkinë e Parmës nga zyrtarë të qeverisë lokale, si Presidenti i Këshillit Komunal z. Alessandro Tassi Carboni e Këshilltari i Komunës, z. Leonardo Spadi. Gjatë takimit u diskutua për forcimin e marrëdhënieve dhe intensifikimin e shkëmbimeve kulturore dhe ekonomike mes dy vendeve.

-Dy Ministrat u takuan edhe me studentë shqiptarë të universitetit të Parmës. Të rinjtë u njohën me disa pika të projektit “Angazhimi i diasporës shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, i cili parashikon ndër të tjera, shfrytëzimin e potencialit të të rinjve të talentuar në Itali për zhvillimin e vendit.

-Gjatë qëndrimit në Parma, Ministri i Shtetit për Diasporën vizitoi dy sipërmarrje të drejtuara nga shqiptarë, firmën “Lira” dhe “Special Inox”.

BOLOGNA

-Arsimi shqip në Itali, ishte në qendër të diskutimeve që zhvilluan dy Ministrat Pandeli Majko dhe Lindita Nikolla, me Kryetarin e Bashkisë së Bolonjës, z. Virginio Merola dhe Zëvendëskryetaren znj. Marinela Pilati. Duke i falënderuar për mbështetjen që u kanë ofruar studentëve shqiptarë, Ministri Majko kërkoi bashkëpunimin e autoriteteve rajonale që fëmijët shqiptarë të mësojnë gjuhën shqipe. Ministri i njohu zyrtarët e lartë me eksperiencat pozitive që kishte hasur në vende të tjera, ku krijohej hapësira e mësimi të shipes gjatë fundjavës.

-Ministrat Pandeli Majko dhe Lindita Nikolla vizituan Bibliotekën Universitare të Bolonjës, një prej më të mëdhave në Europë. Pjesë e trashëgimisë së paçmuar prej qindra mijëra vëllimesh e dorëshkrimesh, janë edhe librat shqip, të grupuar në një seksion të veçantë. Znj. Monica Pedresini, përgjegjëse e departamentit të librit të huaj, shoqëroi Ministrat teksa vizitonin seksionin me rreth 300 libra të autorëve shqiptarë, i themeluar me ndihmën e shoqatës “Të gjithë së bashku”.

-Më 28 mars 2018, Ministrat Majko dhe Nikolla zhvilluan një takim të rëndësishëm me Presidenten e Asamblesë Legjislative të Rajonit, znj. Simoneta Saliera. Në takimin ku ishte i pranishëm edhe Zëvendëspresidenti i Komisionit të Politikave Ekonomike të këtij rajoni, Ministri Majko përsëriti nevojën e një bashkëpunimi sa i përket organizimit të bizneseve shqiptare. Gjatë bisedimeve u fol për mundësinë e organizimit të një takimi vjetor të sipërmarrësve shqiptarë me mbështetjen rajonale.

-Më pas dy Ministrat zhvilluan një bashkëbisedim me përfaqësues të shoqatave e komunitetit shqiptar në Bologna.

-Takim me Zëvendëspresidenten e rajonit të Emilia Romagna, znj. Elisabetta Gualmini, ku u tha se shqiptarët janë një prej komuniteteve të integruara më mirë, si në arsim ashtu edhe në sektorë të ndryshëm të punës.

-Bashkëpunimi në fushën kulturore, shkencore e të arsimit ishte në qendër të bisedimeve mes Ministrave Pandeli Majko e Lindita Nikolla dhe Zëvendësprefektes së Bolonjës, znj. Adriana Cogode. Në takimet e zhvilluara në Bolonjë, Ministrat u shoqëruan nga përfaqësuesi i rrejtit ‘FARE’, z. Roland Jace.

Turqi, 01-04 Prill 2018

Vizita zyrtare në Turqi u organizua nga Ambasada Shqiptare në Turqi.

ANKARA

-Takimet e përfaqësisë së Ministrit të Shtetit për Diasporën, i shoqëruar nga ambasadorët e Shqipërisë dhe Kosovës në Turqi, z. Genti Gazheli dhe z. Avni Spahiu, nisën në qendrën e kulturës shqiptare në Ankara. Të pranishëm ishin përfaqësues të shoqatave shqiptare të tilla si, “Vatra” e “Çamëria” si dhe studentë e profesionistë.

-Në takimin me Zëvendëskryeministrin turk Hakan Cavuşoglu, ky i fundit e siguroi Ministrin se bashkëpunimi mes dy vendeve do të vazhdojë të jetë i fortë në të gjitha fushat dhe theksoi gatishmërinë për të ndihmuar në implementimin e projekteve të ndryshme. Ndërsa vlerësoi përpjekjet e autoriteteve turke në kuadër të ruajtjes së identitetit dhe kulturës shqiptare tek diaspora jonë atje, Ministri Majko kërkoi bashkëpunimin e tyre në ngritjen e një qendre botimi për librat shqip. Zëvendëskryeministri u shpreh i gatshëm të ndihmojë për realizimin e këtij projekti.

-I shoqëruar nga Ambasadori i Shqipërisë në Turqi, Genti Gazheli, Ministri Majko zhvilloi takim me drejtorin e Institutit të Diasporës në Ankara, z. Mehmet Köse, nga i cili mori garancinë për përkushtimin e veçantë të autoriteteve turke lidhur me diasporën shqiptare atje.

-Në takimin me Grupin Parlamentar të Miqësisë Shqipëri-Turqi, ishte në fokus thellimi i marrëdhënieve mes dy vendeve. Gjatë bisedës së zhvilluar në ambientet e parlamentit turk, u diskutua për mundësinë e takimeve të rregullta midis Grupeve Parlamentare të Miqësisë për të forcuar edhe më tej lidhjet mes Turqisë dhe Shqipërisë. Parlamentarët turk shprehën interesin për bashkëpunim në fusha të ndryshme, veçanërisht atë të diasporës.

-Takim me Ministrin e Rinisë dhe Sporteve në Turqi, z. Osman Aşkın Bak, i cili shprehu gatishmërinë për programe e projekte të përbashkëta, që do të kenë në qendër të rinjtë. U fol gjithashtu për mundësinë e angazhimit më të madh të diasporës shqiptare në Turqi në aktivitete e iniciativa të ndryshme.

STAMBOLL

-Homazhe në varrin e shkrimtarit dhe rilindasit të njohur Sami Frashëri dhe vizitë në Muzeun e Gallatarait.

-Z. Majko bëri një ndalesë edhe në Liceun 537 vjeçar të Gallatarait ku u shoqërua nga Konsulli shqiptar në Stamboll z. Agron Tare dhe përfaqësues të komunitetit.

-Gjatë takimit me shoqatat shqiptare në Stamboll, organizuar nga shoqata “Vatra” – Ministri Majko informoi të pranishmit për takimet e rëndësishme që kishte zhvilluar me përfaqësuesit e lartë të qeverisë turke gjatë kësaj vizite dhe foli gjithashtu për rëndësinë e krijimit të qendrave të tjera kulturore si ajo e Ankarasë dhe koordinimit më të mirë të shtetasve me origjinë shqiptare që jetojnë atje. Për mësimin plotësues të gjuhës amtare, z. Majko foli për iniciativën e realizimit të një kurikule të përbashkët me Kosovën dhe regjistrin zyrtar të të gjithë mësuesëve të diasporës.

ZYRIH

-Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko vizitoi Konsullatën e Zyrihut, ku u takua me Konsullën e Nderit znj. Anita Winter. Ministri foli për hapat e ndërmarrë deri më tani për të forcuar marrëdhënien e shtetit me diasporën. Ai u ndal në veçanti tek Ligji “Për Diasporën”, i miratuar në parlament, që do të mundësojë ngritjen e strukturave mbështetëse për shqiptarët jashtë vendit.

-I shoqëruar nga Ambasadori i Shqipërisë Ilir Gjoni, Ministri Majko vizitoi qendrën Pesstalozi Hardau e drejtuar nga znj. Suela Jorgaqi. Qendra interkulturore e themeluar në 2009-n, i dedikohet të gjitha kategorive dhe grupmoshave të popullsisë. Ajo shërben edhe si bibliotekë, ku mes mijera titujve ka edhe literature në gjuhën shqipe.

-Në qendrën Pesstalozi, Ministri Majko zhvilloi një takim me Lidhjen e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë në Zvicër. Gjatë takimit u diskutua për shqetësimet e komunitetit shqiptar sa i përket arsimit dhe për ide dhe projekte që do të mundësojnë një qasje më të lehtë ndaj librave shqip. U fol për aspektet organizative dhe financiare të marrëveshjes midis qeverisë së Shqipërisë dhe Kosovës, e cila parashikon ndër të tjera ngritjen e dhjetëra qendrave kulturore.

LOZANE

-Ministri Majko u takua me drejtuesit e Institutit të Studimeve Shqiptare në Lozanë (ISEAL) dhe me drejtuesit e Portalit Informativ Albinfo.ch.

-Krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga diaspora, ishin në fokus të takimit që Ministrat Pandeli Majko dhe Dardan Gashi zhvilluan me përfaqësues të rrjetit të bizneseve shqiptare në Zvicër. Duke e vënë theksin tek numri i lartë i sipërmarrësve shqiptarë në Zvicër, Gjermani, por edhe në vendet e tjera të botës, z. Majko pranoi rolin jetësor që do të kishin investimet në rritjen ekonomike. Ndërsa pranoi sfidat e mëdha me të cilat përballen për t'u garantuar sipërmarrësve një ambient të favorshëm, Ministri theksoi se qeveria po ndërmerr reforma të rëndësishme në këtë aspekt. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e bizneseve, kërkuan mbështetjen e dy qeverive në identifikimin dhe regjistrimin e sipërmarrësve shqiptarë në Zvicër dhe Gjermani.

BOSTON

-Vizita e tij filloi me pjesëmarrjen në konferencën e 10-të për «Fuqizimin Global» në Universitetin e Harvardit, ku ndër të tjera u fol edhe për rolin e emigrantëve në zhvillimin ekonomik.

HOUSTON, TEKSAS

-Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko u takua me përfaqësues të suksesshëm të komunitetit shqiptar në Houston e përfaqësues të shoqatave shqiptare që veprojnë atje. U përmend çështja e regjistrimit të fëmijëve dhe mundësimi i qasjes elektronike ndaj librave shqip. Majko përmendi përpjekjet që po bëhen për të ashtuquajturin «e-book», projekt që do të mundësojë publikimin online të të gjitha librave të kurikulës së përbashkët me Kosovën. Z. Majko përcolli tek komuniteti në Houston, lajmin pozitiv për dekretimin e Ligjit «Për Diasporën», i cili ndër të tjera parashikon hapjen e një qendre botimi për diasporën.

FLORIDA

-Biznesi dhe zhvillimi ekonomik ishin në qendër të bisedimeve që zhvilloi Ministri i Shtetit për Diasporën me «Rrjetin e Bizneseve dhe Profesionistëve Shqiptarë», në Tampa Bay të Floridës. Organizata, e krijuar në 2016-ën, promovon sipërmarrjet shqiptare dhe cilësitë e komunitetit përmes ndërlidhjes, seminareve dhe marketingut.

-Vizita e Ministrit Majko vijoi në një takim me komunitetin shqiptar në Clearwater, ku jeton një komunitet i konsoliduar shqiptar. Duke e vënë theksin tek modeli i suksesshëm i integritit të qytetarëve me kombësi të ndryshme në këtë shtet, Kryebashkiaku i qytetit e siguroi Ministrin se traditat dhe kultura shqiptare vazhdojnë të jetojnë edhe tek brezat e rinj. Gjatë takimit folën drejtues e përfaqësues të shoqatave të tilla si AANO, Organizatës së Grave Shqiptaro-Amerikane, Motrat Qiriaz, Fondacionit «Albanian Heritage» etj, të cilët prezantuan veprimtaritë e tyre dhe i drejtuan pyetje Ministrin mbi problematika të ndryshme.

-Në Clearwater, Ministri vizitoi «Qendrën Kulturore Islamike Shqiptare». Në strukturën e zotëruar nga shqiptarë, ligjërata mbahet çdo të premte; 20 minuta në gjuhën shqipe dhe 20 minuta në anglisht. Qendra ka funksionuar edhe si shkollë e gjuhës shqipe gjatë së shtunës dhe të dielës, ku mësuesi ishte ka

CHICAGO

-Ministri vizitoi Kisha Ortodokse Shqiptare «Shën Nikolla» dhe Qendrën Islamike Shqiptaro-Amerikane në Chicago, me një kontribut të çmuar në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe gjuhës shqipe.

-Z. Majko, zhvilloi një takim me Komunitetin Shqiptar të Illinois (AACI) duke vlerësuar maksimalisht punën e shoqatave që veprojnë atje. Ai tha se do të përkrahë çdo iniciativë organizuese të tyre.

CANBERRA

-Takim me zyrtarë të lartë në Ministrinë e Jashtme Australiane dhe në Departamentin e Arsimit dhe Trajnimeve. Z. Majko i kërkoi Drejtorit për Evropën dhe Azinë në Departamentin e Arsimit, z. Craig Johnson, bashkëpunimin në projektin e shpërndarjes së librave shqip në Australi dhe atë të mundësitë të librave online. Zyrtari i lartë Australian vlerësoi iniciativën e qeverisë shqiptare në bashkëpunim me atë të Kosovës, duke shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në realizimin e këtij projekti. Ndërkaq, në takimin me Zvsekretarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Christofer Langman, u diskutua për bashkëpunimin e të dyja vendeve për hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Australi.

-Ministri Majko, zhvilloi një bisedë miqësore me Sekretarin për Emigracionin dhe Politikat multikulturore, z. Richard Johnson, i cili pohoi se çdo vit, vendi i tij priste një numër të madh emigrantësh, të përkohshëm dhe të përhershëm, duke i lënë hapësirë të veçantë studentëve. Ministri Majko vlerësoi lart politikat e shtetit Australian për emigrantët dhe i falënderoi autoritetet për mbështetjen që i kanë ofruar komunitetit shqiptar në veçanti. Sekretari për Emigracionin theksoi se ndihma e Australisë për emigrantët përqendrohej në tre shtylla kryesore, që sipas tij, përbënin edhe çelësin e suksesit; punësimi, arsimit dhe gjuha angleze.

MELBURN

-Takim me përfaqësues të diasporës shqiptare në Melburn. Ndërsa e vuri theksin tek rëndësia e përfshirjes së gjuhës shqipe në programin shkollor në zonat ku jetojnë shqiptarë, z. Majko kërkoi bashkëpunimin e shoqatave shqiptare dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit në organizimin e aktiviteteve të rregullta vjetore, ku do të mbledheshin shqiptarët. Ministri foli për planet e ngritjes së një qendre kulturore në Australi, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Melburn shprehën kënaqësinë për vizitën e Ministrit Majko dhe u ofruan të ndihmojnë për ruajtjen e kulturës dhe identitetit shqiptar tek brezi i ri.

SHEPPARTON

-Në qytetin e Shepparton, i konsideruar si kryeqyteti i shqiptarëve në Australi, Ministri Majko u takua me përfaqësues të suksesshëm të diasporës. Gjatë takimit, përfaqësuesit e komunitetit folën për përpjekjet e tyre për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore, duke ngritur xhaminë e parë në shtetin e Viktorias dhe duke organizuar aktivitete të ndryshme.

SIDNEY

Takim me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Sydney. Ministri propozoi që mësimi i gjuhës të ndërledhej me aktivitete argëtuese. Vëmendje të veçantë iu kushtua projektit për publikimin e librave online.

Itali, 14-16 Maj 2018

Vizita në Itali (Pescara, Ancona, Toscana) u realizua me ftesë dhe organizim të komunitetit shqiptar.

PESCARA

-Ne takimet e zhvilluara me Presidentin e rajonit të Abruzzo-s z. Luciano D'Alfonso dhe Kryebashkiakun e qytetit të Pescara z. Marco Alessandrini, Ministri i Shtetit për Diasporën paraqiti kërkesën e tij për zhvillimin e kurseve shqipe brenda ambienteve të shkollave italiane.

Gjatë takimit me presidentin e rajoni të Abruzzo-s z. D'Alfonso, u fol për një program të përbashkët në Villa Badessa, zonë e populluar nga arbëreshët në Pescara. Palët u dakordësuan edhe për një aktivitet vjetor të shqiptarëve në zonë. Një tjetër çështje e rëndësishme e përmendur në takim, ishte rikthimi i linjës direkte të fluturimit mes Pescara-s dhe Tiranës. Ndërkaq, kryetari i Bashkisë së qytetit të Pescarës z. Alessandrini, siguroi Ministrin për vëmendjen e veçantë që i kushtonin integritit.

TOLLO

-Takim me Kryebashkiakun e qytetit, z. Angelo Radica i cili theksoi integrimin e mirë të shqiptarëve në Tollo.

-Takim me përfaqësues të komunitetit shqiptar dhe vizita në ambientet e sipërmarrjeve të suksesshme shqiptare.

ANCONA

-Takim me Presidentin e rajonit të March, z. Luca Ceriscioli dhe Kryetaren e Bashkisë së qytetit të Ancona-s z. Valeria Mancinelli. Z. Majko avancoi sërish kërkesën për mundësimin e kurseve të gjuhës në ambientet e shkollave. Të dy zyrtarët e lartë e vlerësuan si tepër interesant projektin, dhe thanë se do të propozojnë që fillimisht ai të zbatohet në qytetet e mëdha si Ancona.

-Pjesëtarët e shoqatave të shumta që veprojnë në Ancona, ndër të cilat "Aquila" dhe "San Benedetto", e njohën Ministrin me aktivitetet e tyre për promovimin e kulturës dhe identitetit shqiptar. U fol për planet e organizimit të një federate futbollit që do të mbajë vulën shqiptare, një aktiviteti të përbashkët të shkollave shqipe në rajon dhe ngritjes së një busti të shenjtores shqiptare "Nënë Tereza" në një prej shesheve të qytetit.

FIRENZE

- Raportet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Italisë dhe roli i rëndësishëm që kanë emigrantët shqiptarët në shtetin fqinjë, ishin në qendër të diskutimeve që zhvilloi Ministri i Shtetit për Diasporën me Presidentin e Këshillit Rajonal të Toscana-s, z. Eugenio Giani dhe Kryetarin e Bashkisë së Firenze-s, z. Dario Nardella. U fol për investimet që sipërmarrje të shumta në Firenze, planifikojnë të bëjnë në Shqipëri dhe për projekte të bashkëpunimit kulturor. Kryetari i Bashkisë siguroi Ministrin se do të shohin me prioritet kërkesën e tij për zhvillimin e kurseve shqipe brenda shkollave.

Itali, 26-28 Maj 2018

Vizitë pune në Sicili e Kalabri, e realizuar me ftesë dhe organizim të komunitetit shqiptar. Në këtë vizitë zyrtare Ministri Majko u shoqërua nga delegacioni i Kosovës: z. Dardan Gashi, Minister i Diasporës dhe Zëvendës kryeministri z. Fatmir Limaj.

KOZENCA, KALABRI

-Ministrat dhe Zëvendëskryeministri i Kosovës z. Fatmir Limaj u takuan me Kryebashkiakun arbëresh të krahinës së Lungro në Kozenca, z. Guiseppino Santoiani, i cili ndal tek rëndësia që kishte krahina e tyre në ruajtjen e gjuhës, zakoneve dhe kulturës arbëreshe. Ai u shpreh i hapur për të intensifikuar dialogun më qeveritë e të dyja vendeve, me qëllim thellimin e bashkëpunimit. Nga ana e tij Ministri Majko shprehu interesin e madh për projekte të përbashkëta në të gjitha fushat.

-Tre zyrtarët morën pjesë në një aktivitet dedikuar traditës arbëreshe. Në ceremoninë ku ishin të pranishëm përfaqësues të një prej diasporave më të vjetra shqiptare në botë, u ndanë çmime për personalitete dhe institucione që kanë kontribuar në promovimin dhe ruajtjen e pasurisë së rajonit; traditës dhe kulturës arbëreshe. Në aktivitet u vu theksi tek lidhjet e forta vëllazërore mes arbëreshëve dhe shqiptarëve të Shqipërisë e Kosovës dhe tek nevoja për t'i ruajtur dhe çuar përpara vlerat e përbashkëta. Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Majko propozoi firmosjen e një memorandumit bashkëpunimi mes dy Ministrave të Diasporës dhe Institutit Arbëresh dhe gjithashtu caktimin e një date dedikuar arbëreshëve në parlamentet e Shqipërisë dhe Kosovës, ku do të ketë të ftuar të veçantë nga komuniteti.

-Forcimi i lidhjeve përmes projekteve të përbashkëta social-kulturore, ishte në qendër të bisedimeve që zhvilloi Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko dhe dy zyrtarët e lartë të Kosovës, z. Dardan Gashi e z. Fatmir Limaj, me Kryetarin e Bashkisë së Firmo në Kozenca, z. Gennarino Russo.

-Më pas Ministri Majko vizitoi qytezën e Macchias, qytetin e lindjes së rilindasit Jeronim De Rada. Z. Majko i bëri homazhe shkrimtarit të shquar arbëresh, duke vendosur lule në varrin e tij.

PIANA DEGLI ALBANESI, SICILI

-Takim me Kryetarin e Bashkisë, Ing. Rosario Petta, i cili njoftoi pjesëmarrësit se autoritetet vendore kanë përgatitur dy dokumente për qeverinë e Shqipërisë dhe të Kosovës, në të cilën parashtrajnë një program konkret bashkëpunimi midis autoriteteve rajonale me të dy qeveritë. Ata propozojnë krijimin e një agjencie arbëreshe për koordinimin e bashkëpunimit të komuniteteve arbëreshe dhe autoriteteve rajonale siciliane me qeverinë e Shqipërisë dhe Kosovës.

-Vizitë në sheshin kryesor të komunës Piana degli Albanesi, në të cilin ndodhen statujat e Nënë Terezës dhe Skënderbeut. Ministrat nderuan arbëreshët e rënë në përpjekje për të kultivuar tokat e pashfrytëzuara të baronëve në vitet '50-të në Portella della Ginestra, e cila shtrihet në Piana degli Albanesi. Gjithashtu, gjatë vizitës së tyre, Ministri Majko u ndal dhe në Katedralen Piana degli Albanesi.

-Vizitë në muzeun dhe bibliotekën në Piana degli Albanesi, vende ku arbëreshët ruajnë e kultivojnë gjuhën, kulturën e zakonet e tyre prej 600 vjetësh.

-Takime me drejtues të Rajonit të Siçilisë dhe qytetit të Palermos, ku u diskutua për bashkëpunimin midis autoriteteve rajonale e lokale të Siçilisë me qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës. Ministrat zhvilluan takime me kryetarin e Bashkisë të Palermos, Prof. Leoluca Orlando; Presidentin e Kuvendit Rajonal, Gianfranco Miccichè; Zv/Presidentin e Rajonit, Gaetano Armao si dhe autoritete të tjera lokale. Gjatë takimeve u tha se është koha e duhur për të fuqizuar lidhjen midis komuniteteve tona shqiptare dhe Kosovës. Ministri Majko propozoi organizimin e një jave kulturore të shqiptarëve në Siçili, e cila do të promovonte trashëgiminë e çmuar të këtij komuniteti. Gjatë takimeve u diskutua dhe mundësia e hapjes së një linje ajrore direkte midis Palermos dhe Tiranës, e cila do të lehtësojë lëvizjet e shqiptarëve në përgjithësi, por dhe studentëve midis dy qyteteve.

-Vizita e ministrave përfundoi me takimin me Presidentin e Kuvendit Rajonal, Gianfranco Miccichè, i cili u zhvillua në selinë e tij, Palazzo Reale, një pallat me histori 2050 vjeçare.

SHËNIM:

Të gjitha aktivitetet publike të kryera nën kujdesin apo pjesëmarrjen e Ministrisë të Shtetit për Diasporën nuk kanë pasur asnjë shpenzim për buxhetin e shtetit. Udhëtimet kryhen me miratimin e kryeministrit. Blerja e biletave për udhëtimet kryhet nga zyra e prokurimeve në administratën e kryeministrit!

PASQYRA FINANCIARE

	Persona	Dieta	Hotel	Bileta	Tjera	Dieta	Hotel	Bileta	TOT
Udhëtimet viti 2017									
Maqedoni 18-19 nëntor 2017	2	115	100		40				255
Kabineti MSHD shpenzime udhëtimi		EURO	EURO	EURO	EURO	USD	USD	USD	EURO
Udhëtimet viti 2017	Persona	Dieta	Hotel	Bileta	Të tjera	Dieta	Hotel	Bileta	TOT
Kosove 25-26 nëntor 2017	2	115	165		50				330
Gjermani 28-30 nëntor 2017	1	100	233		64				397
Itali 9-10 dhjetor 2017	3	380	456	1470					2306
Udhëtimet viti 2018									
Ukrahinë 13-16 janar 2018	3	570	740						1310
Greqi 24-27 shkurt 2018	3	675	1153		466				2294
Itali 28-30 janar 2018	4	460	994	1323					2777

FALEMINDERIT

